



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Prishtinës*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Lavdim Maxhuni* udhëheqës i ekipit, *Illir Abazi* dhe *Fetah Osmani* anëtarë të ekipës, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Shkëlqim Xhema*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	39
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	41

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Prishtinës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve që të cilat kanë ndikuar në theksim të çështjes.

Menaxhimi financiar dhe Kontrolli - edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive, dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, shpenzimet, obligimet, të arkëtueshmet si dhe pasuritë jo financiare.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohet në nivelin e kërkuar. Prej 21 rekomandimeve, gjashtë (6) ishin zbatuar, dy (2) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, tri (3) rekomandime janë konsideruar të mbyllura, ndërsa 10 rekomandime nuk ishin zbatuar ende.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin¹ të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra e shërbime si dhe anasjelltas. Në këtë raporte kjo çështje është trajtuar tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Prishtinës për vitin 2019 kishte shpenzuar 71% të buxhetit final, që nënkupton një realizim jo të kënaqshëm në nivel të përgjithshëm. Sfidë mbetet niveli i ulët i realizimit të investimeve kapitale, çështje e përcjellë në vijimësi. Vetëm 41% e buxhetit të investimeve kapitale ishte shpenzuar për vitin 2019.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime, janë parandalimi i keq klasifikimit të shpenzimeve dhe zvogëlimi i pagesave me vendime gjyqësore.

Gjithashtu, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet kontrolleve në këto fusha: zvogëlimit të numrin e të angazhuarve me marrëveshje të veçanta, menaxhimi i subvencioneve, menaxhimi i kontratave, menaxhimi dhe efikasiteti i mbledhjes së të hyrave, respektimi i procedurave të prokurimit, menaxhimi i pasurive, vonesave në pagesa, adresimit të rekomandimeve të NjAB-së etj.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimi mit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	87,733,825	110,649,946	78,648,130	71%	61,331,462	57,049,572
Granti i Qeverisë - Buxheti	55,514,920	55,514,921	51,327,902	92%	41,646,451	37,411,514
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	23,342,809	13,212,060	57%	4,426,155	3,041,711
Të hyrat vetjake ⁴	31,733,984	31,733,984	14,073,881	44%	14,697,392	16,230,271
Donacionet e brendshme	-	646	-	-	2,469	-
Donacionet e jashtme	-	36,220	16,224	45%	85,968	123,345
Të hyrat nga huamarrja	484,921	21,366	18,063	85%	473,027	242,731

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 22,916,121€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe një pjesë nga donacionet e jashtme.

Në vitin 2019, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar 71% të buxhetit final ose 78,648,130€, me një përqindje të njëjtë me vitin 2018. Megjithatë, se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet në tabelën më poshtë:

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	87,733,825	110,649,946	78,648,130	71%	61,331,462	57,049,572
Pagat dhe Mëditjet	31,704,278	31,709,758	30,008,502	95%	29,420,508	28,128,949
Mallrat dhe Shërbimet	18,011,479	17,558,030	15,594,153	89%	11,618,992	7,834,544
Shërbimet komunale	2,000,000	2,450,000	2,351,819	96%	1,784,547	1,776,482
Subvencionet dhe Transferet	3,741,400	12,874,485	11,847,911	92%	1,713,941	1,506,072
Investimet Kapitale	32,276,668	46,057,673	18,845,745	41%	16,793,474	17,803,525

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve nuk kishte ndonjë ndryshim mes atij fillestarë që vlen të theksohet;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluare për 453,449€ për arsye se ju është marr komunës buxheti i huamarrjes nga ministria e financave duke marr për bazë nenin 14 të ligjit të buxhetit për Republikën e Kosovës;
- Te Shërbimet komunale kishte rritje të buxhetit për 450,000€ si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake me vendim të asamblesë komunale;
- Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve kishte rritje të buxhetit për 9,133,085€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar; dhe
- Po ashtu te kategoria e investimeve kapitale buxheti ishte rritur për 13,781,004€, e cila ishte prej të hyrave të bartura nga viti i kaluar.

Duhet të theksojmë se me Ligjin për Prishtinën, Komuna në vitin 2019 ka përfituar buxhet shtesë në vlerë prej 10,841,400€, të cilat janë shpërndarë në kategoritë ekonomike si në vijim: Investime kapitale 5,000,000€, Mallra dhe Shërbime 3,000,000€, Paga dhe Mëditje 1,000,000€ si dhe komunal 1,841,400€.

Më tutje, Komuna kishte buxhetuar 46,057,672€ për të investuar në projekte kapitale, nga të cilat kishte shpenzuar vetëm 18,845,745€ apo 41%. Ky trend i ulët i shpenzimit të buxhetit, dëshmon mos angazhimin e komunës për t'i planifikuar, menaxhuar dhe mbikëqyrur realizimin e projekteve kapitale. Po ashtu, në bazë të analizës që kemi bërë është vërejtur se mbi 9 milion euro apo 50% e mjeteve për këtë kategori janë shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit 2019.

Arsyeja përse ka ardhur deri tek kjo është se komuna fillon me projekte pa e zgjidhur çështjet pronëso-ro-juridike, pastaj vonesa në inicimin e procedurave të prokurimit, ankesat në OShP si dhe vonesa në realizimin e punimeve.

Lidhur me klasifikimin e shpenzimeve, ne kemi trajtuar çështjen si në vijim:

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Siç kemi paraqitur të theksimi i çështjes, gjatë vitit 2019 si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit, shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera totale e tyre ishte 2,502,523€⁵. Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe si të tilla ishin aprovuar me ligjin e buxhetit.

Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore (përmba-ruesve private), janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për paga jubilarë të mësimdhënësve vlera prej 832,262€ ku prej këtyre në emër të tarifave përmba-ruimore janë paguar 139,489€.

Megjithatë, lidhur me këto çështje komuna në PFV e vitit 2019 te nenin 6 kishte shpallur vlerat e këtyre keq klasifikimeve si dhe kishte bërë përpjekje që kjo çështje të evitohej.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

⁵ Keq klasifikimet janë konfirmuar edhe nga ana e komunës në PFV, ne kemi vendosur vlerën e keq klasifikimeve në bazë të mostrimit.

2.1.1 Të hyrat

Buxheti i planifikuar i të hyrave vetanake për vitin 2019 ishte 31,733,984€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 28,891,067€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, gjykatat dhe agjencia e pyjeve në vlerë totale prej 2,526,491€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Tatimi në pronë	7,884,621	7,884,621	7,601,297	96%	6,975,295	6,961,321
Taksat komunale	23,849,363	23,849,363	21,289,770	89%	19,307,109	16,598,299
Totali	31,733,984	31,733,984	28,891,067	91%	26,282,404	23,559,620

Vlen të theksohet se në këtë vit krahasuar me vitin e kaluar komuna ka realizuar më shumë të hyra prej 2.6 milion apo shprehur në përqindje 10%. Rritja më e theksuar është tek tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, si dhe shfrytëzimi i hapësirës publike.

Lidhur me testet tona, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A1 - Zonat komunale jo në pajtim me rregulloren

Gjetja Neni 1 i Rregullores Nr 01-463/01-0253544117, i miratuar me datën 10.10.2017, për aplikimin e tatimit në pronë në Komunën e Prishtinës e ka përcaktuar në dhjetë zona të qytetit.

Nga testimi i gjashtë faturave në vlerë prej 1,437€ kemi gjetur se nuk janë përdorur zonat adekuate të përcaktuara me rregullore. Kjo ka ndikuar që të mbi vlerësohet tatimi në pronë në vlerë 596€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos azhurnimit të gjendjes aktuale në teren për aplikimin e tatimit në pronë në pajtueshmëri me Rregulloren e re dhe mos inspektimet e sakta nga vlerësuesit në teren, kur ata e bëjnë incizimin e objektit me iPad mund të ndodhin gabime teknike dhe prona të regjistrohet në zonën e gabueshme.

Ndikimi Rregullorja e pa azhurnuar e tatimit në pronë, jo në përputhje me gjendjen reale në teren dhe mos përputhja e zonave komunale tek fatura e tatimit në pronë me zonat komunale (rrugët e qytetit) në Rregulloren e TP ka për pasojë ndryshimin e bazës tatimore (vlerës së tatueshme) dhe ndikon që tatimpaguesit të faturohen me tepër ose edhe më pak.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që vlerësuesit bëjnë inspektimet e sakta të gjendjes në terren në mënyrë që ngarkesat tatimore të bëhen në përputhje me dhjetë zonat e qytetit të përcaktuara në rregulloren e tatimit në pronë.

Çështja A2 - Faturimi i tatimit në pronë jo në pajtim me udhëzimin administrativ

Gjetja Neni 16 i Udhëzimit Administrativ 03/2011-“Mbi regjistrimin e pronës”, thotë: “Të gjitha objektet e papërfunduara duhet të tatimohen me 40% të vlerës së tregut të objekteve të banimit dhe në llogaritjen e tatimit nuk do të përfshihet zbritja prej 10,000€ shkalla e amortizimit dhe cilësia e ndërtimit, si dhe për ndërtimet e reja deri në pesë vite duhet të llogariten me normë të kualitetit 1.1 e shkëlqyer dhe të jetë 100% e kompletuar”.

Nga 15 mostra të testuara në kemi vërejtur se në 2 raste nga totali i mostrave pronat e papërfunduara janë vlerësuar me normë të kualitetit të ndërtimit 1.1-shkëlqyeshëm dhe kjo pastaj ka rritur shumën e tatimit të vlerësuar. Në rastin tonë shuma e mbivlerësuar për dy mostrat është rreth 2,040€, duke i faturuar më tepër tatimpaguesit. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos verifikimit sistematik të objekteve në teren nga ana e vlerësuesve.

Ndikimi Mos verifikimi i drejt i objekteve në teren nga ana e vlerësuesve si dhe dobësitë në llogaritjen e tatimit të vlerësuar në faturat për tatim në pronë ka ndikuar në dëmtimin apo mbivlerësimin e faturës për taksapaguesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që në mënyrë sistematike bëhet verifikimi i objekteve në teren, në mënyrë që pronat të vlerësohen dhe faturohen saktë.

Çështja A3 -Vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit

Gjetja Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit të Ndërtimit me Nr. 04/L-110 thotë: “leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III.

Nga testimi 15 lejeve të ndërtimit, në 10 raste ka vonesa në lëshimin e lejeve brenda afatit ligjor, prej një muaj e deri me 16 muaj vonesa. Po ashtu, numri i madh i kërkesave për leje të ndërtimit dhe mos mbajtja e lëndëve në mënyrë të organizuar sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH me Nr. 06-2917- "Për përcaktimin e procedurave mbi përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve -Aneksi 2 ", ku përcaktohen kërkesat për kushte ndërtimor, dokumentacioni dhe mënyra e kompletimit të lëndës, nga ana e zyrtarëve shkaktajnë vonesa në kompletimin e dokumentacionit dhe vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit.

Ndikimi Vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit do të pamundësojnë mbledhjen me kohë (arkëtimin) e të hyrave nga lejet e ndërtimit. Njëherit, këto vonesa do të ndikojnë në vonesa për fillimin e punëve për bizneset që operojnë në komunën e Prishtinës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që janë duke u respektuar afatet ligjore me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit, kur kërkesat janë plotësuar nga organet kompetente që kanë bërë kërkesën për lejen ndërtimore.

Çështja B2 - Shfrytëzim i pronave publike me kontrata të skaduar

Gjetja Në bazë të vendimit të kuvendit komunal, në vitin 2007 ishin dhënë me qira 21 banesa për ish këshilltarët komunal. Ndërsa, me vendimin e komisionit për çështje banesore në vitin 2008 ishin dhënë edhe 22 banesa tjera me qira për punëtorë administrativ.

Prej tyre, ne kemi testuar katër raste dhe kemi gjetur se këto kontrata kanë skaduar dhe të njëjtat nuk janë vazhduar më. Qiramarrësit vazhdojnë të shfrytëzojnë banesat. Përveç kësaj edhe pse kompensimi ishte minimal pagesa e qirasë nuk ishte bërë në kohë të rregullt dhe figuronin borxhe në vlerë 15,874€ kurse një qiramarrës edhe pse me kontrate të skaduar ka bërë pagesën prej 297€. Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, menaxhmenti ende nuk kishte ndërmarr masa, dhe se aktualisht sipas tyre ishin në proces të evidentimit të gjendjes aktuale të këtyre pronave që më pas të trajtohen sipas ligjit.

Ndikimi Shfrytëzimi i pronave komunale me kontrata të skaduar apo në mungesë të tyre, ndikon që komuna të humb të drejtën për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarve gjyqësore në raste të mos arkëtimin të të hyrave. Kjo po ashtu tregon që komuna nuk ka arritur që të ketë nën menaxhim pronën e saj.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimin e të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.

Çështja B3 - Shfrytëzimi i pronave publike(komunale) nga bizneset pa asnjë kompensim

Gjetja Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale 03-L040 neni 14, Statutit të komunës neni 33.2- a, dhe Ligjit 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës vihet në pah mundësia/mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

Në vitin 2014 komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat që janë në pjesën e quajtur "Zona Industriale". Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 hektarë, shfrytëzohen nga biznese të ndryshme pa asnjë kompensim ndaj komunës. Kjo çështje është ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar dhe vazhdon të mbetet e pazgjidhur. Megjithatë, nga komuna nuk është ofruar ndonjë shpjegim konkret se pse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ta adresuar këtë çështje.

Sipas kalkulimit të thjeshtë krahasuar me qiratë tjera i bie që komuna humb së paku 6€/m² apo 360,000€/muaj.

Ndikimi Lënia e pronave komunale në shfrytëzim të bizneseve pa marrëveshje/kontratë dëmton të hyrat e komunës dhe rrit rrezikun që shfrytëzuesit të manipulojnë me ato prona.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.

Çështja B4 - Sfidat për arkëtimin e taksave nga bizneset

Gjetja Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, Nr.110-2782, parasheh ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste në komunë.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik, e cila është e ngarkuar me këtë çështje nuk ka informata për numrin e veprimtarive afariste që janë të obliguara të paguajnë taksën komunale. Të hyrat nga kjo taksë mbështeten në deklarimin vullnetar të bizneseve, ngase atyre nuk iu lëshohet paraprakisht faturë. Në këtë vit, nga kjo taksë janë mbledhur 49,750€, për dallim që vitin e kaluar ishin mbledhur 63,227€.

Ndikimi Arkëtimi i të hyrave bazuar në vullnetin e bizneseve ndikon direkt në uljen e të hyrave totale të komunës dhe në planifikim jo real të të hyrave nga ushtrimi i veprimtarive.

Rekomandimi B4 Kryetari të ndërmarrë masa se të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal, faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga e Mëditje ishte 31,709,758€, ndërsa ishin shpenzuar 30,008,502€. Numri i planifikuar i punëtorëve sipas buxhetit ishte 4,737 ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 4,917.

Dallimi në mes të numrit aktual dhe të planifikuar është për arsye të angazhimit të punonjësve arsimor në rastet e zëvendësimit të pushimeve të lehonisë. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 205 punonjës të rinj, ku prej tyre 65 janë punësuar për kohë të caktuar.

Për këto shpenzime, ne kemi testuar 66 mostra për teste substanciale në vlerë 38,218€, si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja C1 - Mangësi në Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta

Gjetja Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, neni 12, dhe Ligji i Punës, neni 10, i rregullojnë çështjet e angazhimeve të punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Afati maksimal për MSHV është 6 muaj.

Siç është prezantuar në PFV për vitin 2019, Komuna e Prishtinës kishte të angazhuar 176 punonjës me MSHV me orar të plotë dhe 34 punonjës me orar të shkurtër (nga një ditë deri në dy muaj). Angazhimet e tyre ishin bërë për periudha të ndryshme, që nga 1 ditë deri në 6 muaj. Nga 9 mostra të testuara, në 5 nga to, pas përfundimit të kontratave fillestare 6 mujore, ishin nënshkruar kontrata pasuese. Ndërsa në 4 raste, punonjësit ishin angazhuar nga viti në vit.

Shkak i aplikimit të kësaj forme të angazhimit të punonjësve është mos aprovimi i kërkesave për pozita të punës me Ligjin e Buxhetit, si dhe nevoja e angazhimit të punonjësve për kryerjen e punëve me kohë të caktuar gjatë vitit.

Ndikimi Mbulimi i pozitave me MSHV, kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të pranohet staf me kompetencë të ulët që ka ndikim në cilësia e shërbimeve të pranuar si dhe mund të ndikoj që objektivat e përcaktuara të mos arrihen apo të realizohen sipas programit vjetor të punës.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për pozita të rregullta dhe afatgjata të punës, aty ku është e nevojshme, të adresohen në MF përmes planifikimeve adekuate buxhetore, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe shpenzimet komunale në vitin 2019 ishte 20,008,030€, prej tyre ishin shpenzuar 17,945,972€. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të auto rrugëve, shpenzime komunale, ngrohje qendrore, furnizime për zyre, etj. Për këto kategori, kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 7,891,464€ si dhe 74 mostra për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A4 - Dobësi në menaxhimin e kontratave publike

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi operativ i prokurimit publik, përkatësisht pika 61 – Menaxhimi i kontratës, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës (MK) në menaxhimin e kontratave publike. MK duhet të sigurojnë se Kontrata po realizohet në përputhje me kushtet kontraktuale. Po ashtu, në kontratën e lidhur me Trafikun Urban për ofrimin e shërbimeve të transportit publik, obligimet mujore të komunës ndaj kontraktuesit kalkulohen sipas formulës: kilometrat mujore të kaluara x çmimi i kontraktuar – të hyrat mujore të realizuara nga kontraktuesi.

Lidhur me menaxhimin e kontratave publike, ne kemi identifikuar mangësi si në vijim:

- Në dy⁶ kontrata publike kornizë, drejtorët e shkollave dhe menaxheri i kontratave kishin pranuar shërbimet e pastrimit për muajt Mars dhe Dhjetor në vlerë 77,606€ pa u përfunduar muaji.

Vlen të theksohet, se një muaj pas nënshkrimit të kontratës për *Pastrimin e objekteve shkollore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Naim Frashëri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevor*i, zyra e prokurimit kishte amandamentuar kontratën dhe kishte rekomanduar rritjen prej 4% të pagës për 83 punonjësit e kompanisë të kontraktuar për mirëmbajtjen e objekteve shkollore në vlerë mujore prej 1,079,30€.

Sipas këtij amendamenti, kjo rritje do të përfshinte periudhën nga data 01.01.2018 deri 30.11.2019 në vlerë totale prej 24,824€. Për muajt vijues pagesa shtesë mujore ndaj kryesit të shërbimeve do të jetë çmimi i kontraktuar 32,291€ plus shtesa 1,079€. Në pagesën e shërbimeve të pastrimit të muajit dhjetor pagesa mujore e kontraktuar ishte rritur edhe për 4% në emër të rritjes së pagave për punëtorët e operatorit ekonomik të kontraktuar; dhe

⁶ Kontrata publike kornize për Pastrimin e objekteve shkollore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Naim Frashëri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbert dhe PNF në Kolovice, si dhe te kontrata për Pastrimin e objekteve shkollore – Abdyl Frashëri, 7 Shtatori, Prenk Jakova, Eqrem Qabej, Hoxhë Kadri Prishtina, Gjumnazi matematikor, dhe shkolla Model

- Te “Shërbimet e transportit publik në Komunën e Prishtinës” – Menaxherët e kontratave nuk kishin arritur të sigurojnë dëshmi të mjaftueshme për të hyrat mujore të realizuara nga shërbimet e transportit publik për të mbështetur kompensimin e pjesës së mbetur apo obligimin mujor të Komunës ndaj kontraktuesit. Kontraktuesi kishte dorëzuar një raport përshkrues rreth kilometrave të kaluara dhe të hyrave mujore të arkëtuar por pa ndonjë dokument që vërteton/dëshmon të hyrat mujore (Raport fiskal apo deklaratë mujore të raportimit në ATK).

Kjo ka ndodhur për arsye të kontroleve jo adekuate dhe mbikëqyrjen e pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave.

Ndikimi

Menaxhimi dhe monitorimi i dobët i kontratave mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale, rrjedhimisht në mos arritjen e objektivave dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë, siç dhe mos arrihet vlera për paranë e dhënë. Njëherit ndryshimi i kushteve të kontratës do të ndikojë në shpenzime të paplanifikuara dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth implementimit të kontratave.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 12,874,485€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 11,847,911€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e OJQ-ve për projekte sportive dhe kulturore, përfituesve individualë, si dhe ndihmës financiare për ndërmarrjet publike që janë nën menaxhim të komunës. Për këto shpenzime, ne kemi testuar 25 mostra për teste substanciale në vlerë prej 10,418,579€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë, për të cilat kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A5 - Mangësi në procesin e subvencionimit të OJQ-vë

Gjetja Rregullorja MF Nr.04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, Po me këtë rregullore, gjithashtu kërkohet që përfituesit e subvencioneve të raportojnë dhe të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare për projektet e realizuara.

Nga ekzaminimi i mostrave të përzgjedhura për auditim, kemi identifikuar se:

- Nuk është përgatitur Plani Vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të;
- Në 6 raste në vlerë 54,265€, përfituesit e subvencioneve nuk kishin ofruar dëshmi se nuk kanë obligime tatimore dhe se nuk janë në procedura të falimentimit. Kjo ishte kërkesë e përcaktuar me Thirrjen Publike për Subvencionim, e të cilin komisioni nuk e kishin respektuar gjatë procesit si rezultat i kontrollit jo të mirë; dhe
- Në një rast në vlerë 11,112€, përfituesi i subvencionit nuk kishte dorëzuar raport narrativ dhe financiar rreth realizimit të projektit, kjo për faktin që nuk është monitoruar nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Mos përfillja e kërkesave të kërkuara me thirrjen publike mund të rezultojë që të përzgjidhen përfituesit të cilët mund të kenë obligime të papaguara ndaj institucioneve publike dhe të jenë në vështirësi për vazhdimin të aktivitetit të tyre. Kjo mund të krijojë paqartësi për projektet e financuara duke rrezikuar synimet e organizatës dhe që mjetet të mos shpenzohen për qëllimin e dhënë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e Planit Vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të bëhet brenda afatit të kërkuar me rregullore. Njëherit, të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim gjatë procesit përzgjedhës duke siguruar më tutje monitorim të vazhdueshëm për projektet e financuara.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 46,057,673€, prej tyre për vitin 2019 ishin shpenzuar 18,845,745€, me një nivel të ulët të shpenzimeve sikurse në vitet e kaluara. Investimet kapitale kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, qendrave sociale, çerdheve dhe përmirësime të ndryshme tek objektet dhe inventari etj.

Për këtë kategori, ne kemi testuar 98 mostra për teste substanciale në vlerë 6,720,435€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Ndarje jo e duhur e detyrave të punës

Gjetja Me Rregullën dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit, si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit.

Te kontrata “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Bushgega dhe Geci, Marevc dhe Prapashticë lloti i 1” me vlerë të kontratës 350,485€, kemi vërejtur se zyrtari përgjegjës që kishte hartuar specifikat teknike kishte marrë pjesë në komisionin për vlerësimit të ofertave.

Shkaku i ndodhjes së kësaj ishte kujdesi i duhur i zyrtarëve përgjegjëse për të eliminuar situatën e tillë.

Ndikimi Ndarja jo e duhur e detyrave përgjatë procesit të prokurimit mund të ndikoj në favorizime të mundshme për ndonjë operatori ekonomik të caktuar si dhe në trajtimin jo të barabartë të ofertuesve me rastin e procesit të vlerësimit.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.

Çështja A7 - Mungesa e projekteve ekzekutive me rastin e lëshimit të dosjes së tenderit

Gjetja Sipas UA Nr. 1/2014, si dhe Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) - “Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë”, autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në lidhje me këtë, ne kemi vërejtur se komuna kishte nënshkruar 22 kontrata për punë, në mungesë të projekte ekzekutive. Shkaku i ndodhjes së kësaj sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e një kontrate me ndonjë operator ekonomik për hartimin e projekteve.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesave të udhëzuesit operativ dhe mund të rezultojë me realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara apo studiuara të cilat mund të afektojnë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A7 Kryetari të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Çështja A8- Mos ofrimi i garancionit nga ana e operatorit ekonomik siç parashihet me kontratë

Gjetja Sipas kushteve të veçanta të kontratës së nënshkruar mes operatorit ekonomik dhe autoriteti kontraktues kërkohet që kontraktuesi pasi të përfundoj projektin t'i ofrojë komunës garancinë për 3 vite, në rast të ndonjë defekti nëse paraqitet nevoja.

Ne kemi identifikuar se te kontrata “Ndërtimi i rrugës Shaban Koliqi” në Prishtinë me vlerë të kontratës prej 402,097€, nuk ishte ofruar garancioni nga ana e operatorit ekonomik siç ishte paraparë me kontratë.

Shkaku i ndodhjes ishte mungesa e mbikëqyrjes nga ana e menaxherit të kontratës.

Ndikimi Mos ofrimi i garancionit me rastin e përfundimit të projektit të caktuar ndikon që në raste të shfaqjes së ndonjë defekti të projektit, operatori ekonomik mund të mos ofrojë rregullimet e nevojshme dhe të dalin shpenzime shtesë për komunën.

Rekomandimi A8 Kryetari i komunës duhet të sigurojë se pasi të përfundohet projekti është pranuar garancioni për punët e kryera nga ana e operatorit ekonomik ashtu siç është përcaktuar në kontratë.

Çështja B5 - Vonesa në realizimin e projektit

Gjetja

Sipas kushteve të veçanta të kontratës “Ndërtimi i kolektorit mbi lumin Prishtina” parashihej që plani dinamik për realizimin e këtij projekti të jetë 120 ditë.

Për këtë projekt, kontrata ishte nënshkruar me datën 09.08.2016 në vlerë 2,192,854€, ndërsa ishin realizuar punë në vlerë prej 1,940,750€ ose 88%. Si e tillë, kontrata ishte mbyllur më datën 13.12.2019.

Arsye për se nuk është përmbushur kontrata ishin problemet pronësore që lidhen me këtë projekt në linjën ku zhvillohet kanalizimi fekal i cili nuk është përfunduar komplet. Shkaku i kësaj është fillimi i realizimit të projekteve pa e kryer paraprakisht procesin e shpronësimit.

Ndikimi

Vonesa në realizimin e projekteve jo sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës si dhe fillimi i punimeve pa zgjidhur problemet pronësore, ka ndikuar në tej zgjatjen dhe realizimin jo të plotë të projektit, gjë që dëmton vet cilësinë e punimeve.

Rekomandimi B5

Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe ato të realizohen sipas planit dinamik.

Çështja B6 -Mos respektim i kriterëve të vendosur në dosje të tenderit si dhe dobësi në caktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit**Gjetja**

Me rregullën dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik të neni 40 krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve paragrafi 40.5 thekson se komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë relevante me kërkesat e prokurimit. Po ashtu në dy dosje të tenderit ishin përcaktuar kërkesat apo dokumentet që ofertuesit do të duhej të plotësonin.

Lidhur me këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

- Te kontrata “Furnizim me triopod, projektor dhe drona në vlerë 11,652€, kemi vërejtur se anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk ishin me përvojën relevante siç kërkohet me udhëzuesin e prokurimit. Më tutje, operatori ekonomik fitues kishte sjellë certifikata të ISO standardeve në të cilat nuk figuron emri i operatorit ekonomik, siç ishte kërkuar për produktet ISO 19001:2008 dhe ISO 240001:2004 në dosje të tenderit; dhe
- Te kontrata “Furnizimi me inventarë kuzhine dhe pajisje tjera për çerdhen Yllkat dhe çerdhen Kalabria në vlerë 66,451€, kemi vërejtur se operatori ekonomik fitues nuk i kishte në dosje të gjitha referencat e kërkuara të kontratave për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit me vlerë jo më pak se 40,000€, si dhe referencat e bashkëngjitura ose certifikatat e kryerjes së furnizimeve.

Kjo ka ndodhur në mungesë të komunikimit mes drejtorive për caktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit, si dhe komisionet e vlerësimit të ofertave nuk i kanë kryer punët sipas kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit.

Ndikimi

Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit gjatë vlerësimit të ofertave, si dhe emërimi i anëtarëve të komisionit të vlerësimit jo në pajtim me kërkesat ligjore ndikon që të përzgjidhen ofertuesit të papërgjegjshëm ose të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek vlerësimi i ofertave në mënyrë që të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të jenë njerëz kompetente me njohuritë e fushës përkatëse.

Çështja A9- Mos zbatim të vendimit të kryetarit të Komunës

Gjetja

Me Vendimin e Kryetarit të Komunës caktohen një menaxher i kontratës dhe organi mbikëqyrës, dy apo tre mbikëqyrës, varësisht prej llojit të kontratës dhe natyrës se për çka është lidhur kontrata.

Bazuar në këtë, ne kemi identifikuar se në dy pagesa për projekte kapitale njëra me vlerë 50,000€ dhe tjetra 150,000€ (situacione), zyrtarët e caktuar me vendim të kryetarit të komunës si organ mbikëqyrës nuk kishin nënshkruar në raportin mbi kryerjen e punimeve. Në vend të këtyre janë nënshkruar zyrtarë të tjerë pa ndonjë vendim plotësues të ZKA-së për të justifikuar këtë veprim.

Sipas dëshmive të ofruara nga zyrtarët përgjegjës kjo kishte ndodhur pasi zyrtarët që kanë qenë kompetent kishin qenë të angazhuar me punë të tjera.

Ndikimi

Mos nënshkrimi i zyrtarëve përgjegjës (organit mbikëqyrës) të emëruar me vendimit të kryetarit të komunës ndikon dhe rrezikon që punimet mos të kryhen në pajtim me kushtet e kontratës apo që të pranohen punë apo furnizime të një cilësie më të dobët se ajo e kontraktuar.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët e organit mbikëqyrës të emëruar me vendim të kryetarit, janë duke e mbikëqyrur dhe të njëjtit nënshkruajnë raportin mbi kryerjen e punimeve. Në raste të caktuara të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B7- Zotimi/Urdhër blerja pas pranimit të faturës/punëve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01/2013, procesit për inicimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, urdhër-bleerja, pranimi i mallit dhe më pas fatura.

Nga 198 pagesa të testuara, në 74 prej tyre, që kishin të bënin me investime kapitale dhe mallra e shërbime, nuk janë respektuar rregullat e lartcekura. Urdhër-bleerja dhe zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të punëve/furnizimeve, gjegjësisht pas pranimit të faturës. Ne po i theksojmë vetëm dy raste me detaje:

- Në kontratën "Furnizim me makina (mikser) për përgatitjen e ushqimit të koncentruar për bagëti LOT 3", në vlerë 25,200€, zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë me 5 muaj vonesë; dhe
- Në kontratën kornizë "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Brigadës së zjarrfikësve, në vlerë totale indikativë prej 242,717€, vetëm një pjese e vogël e zotimit ishte bërë një muaj pas nënshkrimit të kontratës.

Shkaku i ndodhjes së kësaj, është mungesa e komunikimit të mirë mes palëve kompetente.

Ndikimi Hyrja në obligime në mungesë të zotimit të mjeteve/urdhër blerjes, mund të shkaktojë rritjen e obligimeve të papaguara dhe si pasojë, ekzekutimin e pagesave direkt nga Thesari.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhër-bleerjes.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 2,455,618,265€, pasurive jokapitale është 1,196,905, si dhe e stoqeve 337,232. Për pasuritë, ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë prej 3,787,546, si dhe në aspektin e pajtueshmërisë kemi kryer 9 testet sipas programit të auditimit. Lidhur me menaxhimin e pasurive, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja B8 - Mos themelimi i komisionit për inventarizim të pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari duhet të themeloj një Komision për inventarizimin e pasurisë me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të pasurisë jo financiare. Ky proces duhet ti paraprij përgatitjes së PFV. Gjatë vitit 2019 nuk ishte bërë, pasi që kryetari nuk kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë.

Ndikimi Mos inventarizimi i pasurisë ndikon dhe rrit rrezikun për informata të mangëta rreth pasurisë së komunës që ka në menaxhim përfshirë këtu ekzistencën dhe gjendjen fizike të pasurisë jo financiare. Mos përfundimi si proces, mund të ndikon që informata e shpalosura për pasuri të mos jenë të plota dhe të sakta.

Rekomandimi B8 Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.

Çështja B9 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

Gjetja

Sipas Rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 6 dhe 10 përcaktojnë që, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrat e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj (SIMFK dhe e-pasuri) dhe të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara.

Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, gjendja është si në vijim:

- Moduli e-Pasuria nuk përdoret, është jofunksional për arsye se kanë probleme nga ana e ministrisë për këtë softuer. Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ mbahen në data bazë të brendshme të komunës në formë të Excel-it, megjithatë ky aplikacion mund të paraqet rrezik të përhershëm për lëshim gabimesh, shlyerje, etj. Për këtë çështje komuna kishte bërë kërkesë në MAP për ta rregulluar këtë, mirëpo ministria nuk kishte bërë asgjë në lidhje me këtë; dhe
- Vazhdojnë edhe më tutje të mbesin të paregjistruara objektet: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim; ish-objekti i gjykatës së Apelit; ish-objekti i gjykatës komunale; ndërtesa ku ndodhet drejtoria e inspeksionit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, edhe toka e shpronësuar për interes, nuk figuron si pasuri e komunës.

Sipas zyrtarëve nga komuna, pritet që gjatë vitit 2020 zyrtarët që menaxhojnë me këtë sistem të ja përcjellim tabelën e migrimit me të dhënat e plotësuara dhe të fillojnë me aplikimin e regjistrimit të pasurive jo kapitale në sistemin e-Pasuria për vitin 2019. Ndërsa për regjistrimin e objekteve të cilat janë në pronësi të komunës theksojnë se duhet të formohet një komision profesional për ti vlerësuar fillimisht pastaj të regjistrohen në regjistra.

Ndikimi

Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e mungesës së regjistrimit të pasurisë, regjistri i tyre është i nënvlerësuar, andaj ekziston rreziku i keqpërdorimit të tyre. Po ashtu, mirëmbajtja manuale e të dhënave paraqet rrezik për lëshim gabimesh.

Rekomandimi B9

Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 50,520,193€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në prone në vlerë prej 34,558,800€, lejet e ndërtimit në vlerë prej 5,809,125€, mbledhja e mbeturinave në vlerë prej 4,417,189€ dhe të nga të hyrat e tjerat në vlerë prej 5,735,079€ (taksat në biznes , borxhi i vjetër i Ministrisë së Planifikimit Hapësinore, Drejtoria e shërbimeve publike dhe te hyrat nga qiraja).

Lidhur me menaxhimin e të arkëtueshmeve, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A10 -Shpalosje jo e saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Bazuar në PFV dhe shënimeve për të arkëtueshmet ne kemi vërejtur se:

- Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldot fillestare, duke mbivlerësuar në PFV këto llogari për 1,525,669€ ;
- Llogarite e arkëtueshme nga të hyrat e lejeve të ndërtimit të prezantuara në PFV në vlerë prej 5,809,125€, janë të nënvlerësuar për 2,185,067€ duke mos i prezantuar në PFV shumat e kësteve që do të paguheshin (arkëtohen) pas vitit 2019; dhe
- Në PFV komuna nuk i kishte shpalosur llogaritë e arkëtueshme nga taksa (tarifa) për rregullimin e infrastrukturës, ku këstet e papaguara (që duhet të arkëtohen pas vitit 2019) kapin shumën prej 1,961,987€;

Për këto, komuna nuk ka arritur të na ofroj dëshmi për të arsyetuar diferencat e paraqitura.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në shpalosjet e llogarive të arkëtueshme, ndikojnë në shpalosjen apo prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV. Njëherit, diferencat e tilla ndikojnë edhe në planifikimet e projekteve të cilat do të mund të planifikoheshin në bazë të efikasitetit të mbledhjes së tyre nga komuna.

Rekomandimi A10 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.

Çështja B10 - Sfidat në menaxhimin apo arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, komuna nuk po arrin të krijoj mekanizma për arkëtimin e llogarive të arkëtueshmet.

Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2019 ishin 50,520,193€. Sfida kryesor mbetet në inkasimin e tatimit në pronë në vlerë prej 34,558,800€⁷, të hyrat nga lejet e ndërtimit në vlerë 5,809,125€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 4,417,189€.

Si pasojë e mos veprimit të mekanizmave adekuat nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra, shumta e llogarive të arkëtueshme është rritur për 5,402,536€ apo 12% në krahasim me vitin 2018. Në raport me vitin e kaluar, rritja e të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë ishte në shumë prej 2,495,462€, nga të hyrat për mbledhjen e mbeturinave në vlerë 2,099,869€ sepse rreth 24,000 amvisni faturohen dhe fare nuk paguajnë⁸.

Ndikimi Mungesa e masave konkrete për të arkëtuar llogaritë e arkëtueshme ka ndikuar në rritje të vlerës së llogarive të arkëtueshme dhe që të mbesin të pa mbledhura duke ndikuar në humbje financiare për komunën. Kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, si dhe masat ligjore për ti mbledhur këto borxhe, të cilat po i shkaktojnë humbje financiare komunës prej vitit në vit.

⁷ Borxhi i larte i tatimit në pronë përfshin nw vete borxhet nga NSH (AKP), vlera e së cilës në fund të vitit 2019 kap shumen prej 10,914,137 € (qe përfshin 31% nga totali), Vlera prej 2,514,107 € janë të arketueshmet nga NSH "Rilindja" dhe të arketueshmet nga pronat fiktive (NN) në sistemin e protaxit, qe kapin shumen prej 313,274 €.

⁸ 24,000*56.40€ (pagesa vjetore e mbeturinave)=1,353,600 €

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 781,108€⁹. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Për këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja C2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Gjatë testimit kemi vërejtur se në 16 raste me vlerë 810,336€, faturat nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Shumica e faturave ishin pranuar në vitin 2018. Vonesat kryesisht janë prej 30 ditë deri në 28 muaj përtej afatit të paraparë ligjor. Shkaku i mos pagesave me kohë ishin kontrollet e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit.

Ndikimi Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rrit mundësinë që furnitorët ti drejtohen përmbauesve dhe gjykatave të cilat krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të forcojë kontrolle të brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 25,329,751€. Prej kësaj vlere, shumica e lëndëve kanë të bëjnë me kompensim dëmi ndaj qytetarëve, pastaj lëndët tjera që kanë të bëjnë me çështjet pronësore, administrative, banesore, penale. Ne për këtë llogari kemi testuar 5 mostra dhe nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në raport.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2019 janë në vlerë prej 27,473,466€¹⁰.

⁹ Kjo shumë e obligimeve i përfshin: mallra dhe shërbime prej 475,864€, shpenzime komunale prej 146,900€, subvencione dhe transfere prej 62,880€ dhe investime kapitale 95,464€, vlerë kjo e shpalosur nga komuna e Prishtinës.

¹⁰ Kjo vlerë është ofruar nga komuna e Prishtinës, është vlerë të cilën ne nuk kemi arritur të auditojmë.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër (4) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së (aktualisht UD) dhe tre auditorë. Në Planin Vjetor të Auditimit kishte planifikuar gjashtë (6) auditime. Prej tyre, kishte arrit që t'i përfundoj katër auditime duke mbuluar më shumë aktivitetet e vitit 2018 dhe jo mjaftueshëm aktivitetet për vitin 2019. Ato kishin mbuluar fusha të ndryshme si: auditimi i lejeve të ndërtimit, të hyrat nga tatimi në pronë, shpenzimet në drejtorinë e administratës dhe auditimi rreth ekzekutimit të buxhetit në drejtorinë e shërbimeve publike.

Komiteti i Auditimit (KA) gjatë vitit 2019 kishte mbajtur katër takime ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së për raportet e vitit 2019, si dhe ishte diskutuar raporti i ZKA-së për vitin 2018. Lidhur më këtë, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A11 - Adresimi i ulët i rekomandimeve të NjAB-së

Gjetja Sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër të tjera, duhet të ndërmer veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Bazuar në këto, ne kemi vlerësuar se rekomandimet e NjAB nga menaxhmentit i Komunës ishin zbatuar vetëm pjesërisht. Prej gjithsej 31 rekomandimeve të dhëna, 8 ishin zbatuar, 10 ishin në proces të zbatimit dhe 13 nuk ishin zbatuar fare. Këtë e vërteton edhe Raporti vjetor i kësaj njësie që e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese tek Ministria e Financave.

Kjo kishte ndodhur për shkak të angazhimit jo të mjaftueshëm nga menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve.

Ndikimi Adresimi i dobët i rekomandimeve të NjAB-së nga menaxhmenti ndikon në mos eliminimin me kohe të dobësive në kontrollet e brendshme.

Rekomandimi A11 Kryetari i Komunës duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 kishte rezultuar me 21 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Ajo ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 6 rekomandime janë zbatuar; 2 ishin pjesërisht të zbatuara, 10 nuk janë adresuar ende, si dhe 3 rekomandime janë konsideruar të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetor	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I pa zbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2019. Performanca buxhetore duhet të rishikohet në baza mujore për të identifikuar në vazhdimësi barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, ndryshimet në projektet kapitale të prezantuara në Tabelën e buxhetit 4.2 "Financimi i Investimeve kapitale Komunale" të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, ashtu siç është	Çështja është mbyllur sa i përket këtij rekomandimi .	I mbyllur.

		e përcaktuar me ligjin e buxhetit aktual.		
3	Pagesat përmes vendimeve gjyqësore	Kryetari, duhet të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të ndërpresë praktikat e krijuara të pagesave, dhe të mos vie deri te pagesat me vendime gjyqësore ose pagesave direkte nga thesari. Shmangia e tyre duhet të bëhet duke respektuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik (menaxhim i mirë të kontratave nga planifikimi, ekzekutimi e deri te raportimi i tyre), si dhe rregullat e thesarit lidhur me zotimin e mjeteve me kohë si dhe hapave tjerë deri në ekzekutimin e pagesave.	Kjo çështja është trajtuar të baza për opinion të auditimit.	I mbyllur.
4	Vonesa në bartjen e të hyrave për shfrytëzim	Kryetari duhet të përshpejtoj diskutimet në Kuvendin Komunal dhe të bëj me kohë propozimet për procesin e bartjes së të hyrave vetanake. Kjo me qëllim që të hyrat e mbledhura nga taksapaguesit të shfrytëzohen në mënyrë efikase, drejt arritjes së realizimit të sa më shumë projekteve kapitale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve.	Komuna në këtë vit kishte marr masa dhe bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake e kishte bërë me kohë.	I zbatuar
5	Shfrytëzim i pronave me kontrata të skaduara	Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që sjellin drejt arkëtimit të të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.	Nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim gjendja mbetet e njëjte si në vitin e kaluar.	I pa zbatuar.
6	Shfrytëzimi i pronave pa kompensim	Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të merr veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.	Nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim gjendja mbetet e njëjte si në vitin e kaluar.	I pa zbatuar.
7	Sfidat për arkëtimin e taksave nga bizneset	Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një bazë të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Me tutje të sigurojë se	Nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim gjendja mbetet e	I pa zbatuar.

		bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.	njëte si në vitin e kaluar.	
8	Pagat dhe Mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV-ve angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa ku kishte shpallur konkurse për rekrutimin e stafit përmes procedurave të thjeshtuara, por edhe më tutje vazhdon angazhimi i një numri të madh të punësuarve në këtë formë.	Pjesërisht i zbatuar.
9	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë sa më saktë nevojat për punët që do të porositen në mënyrë që të mos përsëriten rastet e ngjashme. Ne do të sugjeronim që me rastin e planifikimit të sasive, një rishikim i tyre të bëhet edhe nga një ekip/staf i dytë që ka njohuri për projektin e caktuar.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa dhe në këtë vit nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.
10	Dobësi në menaxhimin i kontratave	Kryetari i komunës të sigurojë se menaxherët e projektit kujdesen që të kryhen të gjitha punët/shërbimet sipas kontratës si dhe pas pranimin të punëve të bëhen vizita në mënyrë që gjatë periudhës garantuese të bëhen sanimet e nevojshme, aty ku paraqitet nevoja. Po ashtu kontratat duhet të lidhen ashtu siç kërkohen me udhëzimet e prokurimit publik.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa dhe në këtë vit nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.
11	Vonesa në realizimin e projekteve	Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre të bëhen projektet precize, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.	Edhe në këtë vit kishte raste të vonesave në realizimin e projekteve.	I pa zbatuar.
12	Kryerja e punëve pa kontratë	Kryetari duhet të sigurojë se janë duke u përfillur kushtet mbi kontratën kornizë, të cilat janë të përcaktuara edhe	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa dhe në këtë vit	I zbatuar.

		me LPP (mbi kohëzgjatjen), dhe të shtojë forcimin e kontrolleve, me qëllim që kontratat të menaxhohen drejtë dhe që punimet/furnizimet të mos kryhen jashtë afateve të përcaktuara me kontratë	nuk kemi hasur në raste të tilla.	
13	Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në zyrën e prokurimit lidhur me vlerësimin e tenderëve në mënyrë që të siguroj që komisioni për vlerësimin e tenderëve bën ekzaminimin e plotë të ofertave përfshirë pozicionet e caktuara me çmimin 0€.	Edhe në këtë vit kishte raste kur procesi i vlerësimit të ofertave kishte mangësi.	I pa zbatuar.
14	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhërbljes.	Menaxhmenti nuk kishte marrë masa edhe në këtë vit kemi pasur raste të tilla.	I pa zbatuar.
15	Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve	Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa dhe në këtë vit nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.
16	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr masa dhe gjendja e pasurive mbetet e njëjtë si në vitin e kaluar.	I pa zbatuar.
17	Dobësi në menaxhimin e pasurive	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.	Moduli e-pasuri edhe në këtë vit nuk është vënë në funksion.	I pa zbatuar.
18	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore apo plane veprimi, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve.	Menaxhmenti nuk kishte arrit të marrë veprime konkrete për ta zgjidhur problemin me llogaritë e arkëtueshme.	I pa zbatuar.

19	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shikojë procesin e prezantimit të obligimeve dhe e pagesave të faturave për të identifikuar dobësitë në proces. Po ashtu të sigurohet se faturat protokollohen.	Ishin marre veprime pjesërisht, obligimet ishin prezantuar drejt në PFV, ndërsa vonesa në pagesa edhe me tutje nuk është eliminuar si çështje.	Pjesërisht i zbatuar.
20	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së dhe Drejtorin e ri të NJAB-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të auditimit të brendshëm komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave.	Ishin marrë veprime për këtë duke e rritur numrin e raporteve në këtë vit.	I zbatuar.
21	4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit për vitin 2019.	I mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që vlerësuesit bëjnë inspektimet e sakta të gjendjes në terren në mënyrë që ngarkesat tatimore të bëhen në përputhje me dhjetë zonat e qytetit të përcaktuara në rregulloren e tatimit në pronë.		
3		Kryetari duhet të sigurojë që në mënyrë sistematike bëhet verifikimi i objekteve në teren, në mënyrë që pronat të vlerësohen dhe faturohen në pajtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.		
4		Kryetari duhet të sigurojë që janë duke u respektuar afatet ligjore me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit, kur kërkesat janë plotësuar nga organet kompetente që kanë bërë kërkesën për lejen ndërtimore.		

5		Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimin e të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.
6		Kryetari, duhet të rishikoj shkaku e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.
7		Kryetari të ndërmarrë masa se të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal, faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.
8	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për pozita të rregullta dhe afatgjata të punës, aty ku është e nevojshme, të adresohen në MF përmes planifikimeve adekuate buxhetore, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.
9	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth implementimit të kontratave.
10	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e Planit Vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të bëhet brenda afatit të kërkuar me rregullore. Njëherit, të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim gjatë procesit përzgjedhës duke siguruar më tutje monitorim të vazhdueshëm për projektet e financuara.
11	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.
12		Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore , që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.
13		Kryetari i komunës duhet të sigurojë se pasi të përfundohet projekti është pranuar garancioni për punët e kryera nga ana e operatorit ekonomik ashtu siç është përcaktuar në kontratë.
14		Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe ato të realizohen sipas planit dinamik.
15		Kryetari i Komunës duhet të shtoj kontrollet tek vlerësimi i ofertave në mënyrë që të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit,

		si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të jenë njerëz kompetente me njohuritë e fushës përkatëse.
16		Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët e organit mbikëqyrës të emëruar me vendim të kryetarit, janë duke e mbikëqyrrur dhe të njëjtit nënshkruajnë raportin mbi kryerjen e punimeve. Në raste të caktuara të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.
17	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhër-blerjes.
18	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.
19		Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.
20	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të ndërmer masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.
21		Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, si dhe masat ligjore për ti mbledhur këto borxhe, të cilat po i shkaktojnë humbje financiare komunës prej vitit në vit.
22	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrole të brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.
23	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keq deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keq deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Shpend Ahmeti

Kryetar i Komunës së Prishtinës

Data: 15.Qershor.2020, Prishtinë,

